MIQTË E VËRTETË KURRË NUK E HARROJNË NJËRI-TJETRIN

(Takim me Yasemin Dobra Mançon – gazetaren turke të “Turkish Daily News” që “zgjoi” opinionin turk dhe atë diplomatik të akredituar në Ankara mbi çështjen e Kosovës.)

Që nga viti 1993, kur shërbenim në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë në Stamboll, na lidhi një miqësi e sinqertë me çiftin e mrekullueshëm turk, Hilmi Manço dhe Yasemin Dobra Manço.

Hilmiu është i biri i zotni Ahmet Bey Manços (turk dhe arbër), i afërm i legjendës së muzikës moderne turke Barış Manço – të dy me origjinë shqiptare. Ata mbajnë me krenari mbiemrin shqiptar Manço. Ndërsa Yasemini është e bija e Alişen Dobrës, gazetarit dhe folësit të parë të Radio Ankarasë, ish-President i Dhomës së Tregtisë SHBA–Arabi, si dhe një mik i shquar i popullit shqiptar.

Në vitet 1993–1997, zonja Yasemin ishte një nga gazetaret më të njohura të të përditshmes turke në gjuhën angleze Turkish Daily News. Ajo botoi një varg artikujsh për Kosovën, ndër të cilët veçohet: “Kosova, nyja (the linchpin) që e mban Ballkanin të varur në fijen e penjit të një lufte të re!”

Në fakt, njoftimet që vinin nga Qendra e Informacionit të Kosovës në Gjenevë (QIK), e udhëhequr nga patrioti i

pashoq z. Xhafer Shatri, Ministër i Informacionit i qeverisë “Bukoshi” në mërgim, pasqyroheshin rregullisht në faqet e asaj gazete, falë penës dhe përkushtimit të Yasemin Dobra Manços.

Që prej asaj kohe, lidhjet tona nuk u ndërprenë kurrë. Takohemi herë pas here në Tiranë, në Stamboll dhe në New York. Edhe këto ditë të ndërrimit të viteve patëm një mbrëmje të paharruar gjatë një darke familjare në restorantin “5 Corners” në Newark, New Jersey, SHBA. Djemtë, atëherë fëmijë të vegjël, sot janë bërë burra.

Ndamë aq shumë kujtime të paharruara miqësie, të cilat gjithmonë I shërbyen të one së kombit one, duke mos harruar se: **Kosova është e lirë edhe falë kontributit të njerëzve të tillë të mrekullueshëm!**

Mirënjohje e përjetshme për miq të tillë!
(Gerçek arkadaşlar birbirlerini asla unutmazlar)
Proud to be Albanian!